



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

VENDIM

Nr. 347, datë 27.07.2022

**PËR
MBARIMIN E STATUSIT TË MAGJISTRATIT
PËR GJYQTAREN E GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR ELBASAN
ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 61 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe në pikën 3, të nenit 65, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës për heqjen dorë nga statusi i magjistratit, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për shkak të dorëheqjes së saj.
2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 31.08.2022.
3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarës znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR